



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 790/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj Kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Jyksel Gjinolli-Sylejmani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apli i parashtruar nga Jyksel Gjinolli-Sylejmani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjilan, nga radhët e subjektit politik PDK me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, me shenjën ZL.Anr.790/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017 në ora 17:40, nga Jyksel Gjinolli-Sylejmani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik PDK me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, me të cilën pretendon se në vendvotimet VV nr. 0401D, 06R, 0401X/03R, 15R, 06R, 02R, 0403D, 02R, 04R, 0404D, 01R, 04R votat e mija janë vjedhur, duke theksuar se posedoj fakte në vendvotimet për të cilat vendvotime ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në apelin e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet VV nr. 0401D, 06R, 0401X/03R, 15R, 06R, 02R, 0403D, 02R, 04R, 0404D, 01R, 04R si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në apel nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet në apel i parashtruar, në kuptim të nenit

117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”. Paneli gjatë vendosjes për një apel i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në apel dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i apelit, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i apelit nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon apelin si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)

Anr.790/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi e Panelit

Rafet Haxhajt

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*